



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

Kabineti i Ministrimit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 101/2015  
Datë: 21.07.2015

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 ( paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 ( shtatë ) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe duke u mbështetur në nenin 3 ( paragrafi 1 ), në nenin 4 ( paragrafi 1 dhe 4), në nenin 5 ( paragrafi 1 dhe 2 ), nenin 7 ( paragrafët 1,2 dhe 3 ) dhe në nenin 8 ( paragrafi 1,2,3 dhe 4) të Rregullores së datës 30.06.2014 për Ndarjen e Çmimeve për Kinematografi, më datën 21.07.2015, mori këtë :

**V E N D I M**

Për Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore “ Bekim Fehmiu” në fushën e Kinematografisë

1. Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore “ Bekim Fehmiu” në fushën e kinematografisë i ndahet aktorit të shquar z. Xhevat Qorraj.
2. Çmimi shoqërohet me Çertifikatë të nënshkruar nga Ministri, më Statuetë dhe shpërblim në vlerë financiare prej 5,000.00 ( pesëmijë) euro.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me rekomandimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e Çmimeve në fushën e kinematografisë, kam vendosur që Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore “ Bekim Fehmiu” t’ia ndaj z. Xhevat Qorraj me motivacionin : *“Për sukseset dhe të arriturat jetësore si aktor i shquar i filmit si dhe për kontributin e tij të veçantë në avancimin e kinematografisë”*.

Kujtim Shala  
Minister



*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministri
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Kulturës;
- Qendrës Kinematografike të Kosovës;
- Fituesit të Çmimit;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së;